

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE SHKODER
NR. 2775 REP.
NR. 1508 KOL.



MARREVESHJE FINANCIMI

Rinovim i Marreveshjes se Financimit Nr. 838 Rep. Nr. 442 Kol. date 26.06.2018

Sot, me date 25.07.2019, ne Shkoder, perpara meje, noter Aleci Saliu Kopurci, me zyre notoriale ne Bulev 100, u paraqiten palët kontraktuese, si vijon:

FINANCUESI: BBSH - Banka e Bashkuar e Shqiperise SH.A., me seli ne Rrugen "Dritan Hoxha", Ndertesa nr. 11, Hyrja 3, Tirane, me License Bankare nr. 03 date 11.01.1999 dhe NIPT J91811004Q, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem Muhamed Prlja, shtetas boshnjak, lindur me 17.04.1972, mbajtes i pasaportes nr. B1390603, banues ne Tirane dhe Fatmir Tresa, Drejtor i Dep. te Riskut, lindur me 05.11.1972 ne Tirane me leternjoftim nr. 029716005 dhe nr. personal H21105117Q, banues ne Tirane.

DHE

KLIENTI i Financuar: - Shoqeria tregtare "ALPIN" sh.p.k., me NUIS K68404710V dhe adrese ne Shkrel REC Mosel, Rec Malesi e Madhe, nr. Pasurie 546/3 ZK 3079, Shkoder, regjistruar si person juridik me date 12.01.2007, perfaqesuar nga ortakja e vetme dhe administratorja **Roze Fran Dedvukaj** lindur me 07.02.1966 ne Ishull Shengjin, Lezhe, me leternjoftim 027600680 dhe nr. personal G65207083F leshuar me 17.09.2009, banuese ne Hot i Ri, Malesi e Madhe; dhe

- **Roze Fran Dedvukaj** lindur me 07.02.1966 ne Ishull Shengjin, Lezhe, me leternjoftim 027600680 dhe nr. personal G65207083F leshuar me 17.09.2009; dhe bashkeshori i saj

- **Nikolin Gjon Dedvukaj**, lindur me 01.12.1957 ne Hot i Ri, Shkoder, me leternjoftim Nr. 032320381 dhe numer personal F71201082F leshuar me date 09.10.2013, te dy banues ne Hot i Ri, Malesi e Madhe, Shkoder.

Palët kontraktuese, te gjithe madhore, këtu e më poshtë të referuara si "Palët", me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, bien dakord të hartojne këtë MARRËVESHJE FINANCIMI. Kjo marreveshje perfaqeson një titull ekzekutiv sipas Nenit 510 te Kodit te Procedures Civile, Shkronja d).

Ata shprehen vullnetin e tyre te lire per te rinovuar Marreveshjen e Financimit Nr. 838 Rep. Nr. 442 Kol. date 26.06.2018 lidhur ne prani te noteres Erida E. Hoxha e Dhomes se Noterise Shkoder, ne baze te Nenit 2 te saj paragrafi 3 te saj, me kushtet dhe afatet e meposhtme.

Neni 1 - Objekti, Qellimi dhe Shuma e Financimit

Klienti ka bere një kerkese dhe ka rene dakort te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme per një financim tjeter murabaha nga BBSH per kapital qarkullues per aktivitetin e tij te licensuar, ne shumen totale **295,000 USD/- (Dyqind e nentdhjete e pese mijë dollare amerikane)** nen Marreveshjen Kuader per Financime me Nr. 842 Rep. Nr. 446 Kol. date 26.06.2018 te lidhur midis paleve.

Kjo shume do te paguhet nga BBSH ne llogarine e Klientit dhe me pas do te transferohet tek furnizuesit e Klientit nepermjet transfertave bankare. BBSH cakton Klientin te negocioje dhe te marre ne dorezim mallrat e blera nga furnizuesi.

Cdo veprim, pagese apo sjellje e Klientit ne kundershtim me qellimin kryesor te ketij financimi, i bere pa miratim paraprak te BBSH-se, mund te rezultoje ne perfundim te parakohshem te kesaj marreveshje, nese kjo vendoset nga BBSH, dhe Klienti merr perjegjesine dhe mban pasojet e shlyerjes se parakohshme te financimit te BBSH-se, qe vjen si rezultat i ketij vendimi te BBSH-se.

Neni 2 - Parimet, kushte praparake dhe Afati i financimit

Palet kane rene dakort qe BBSH te financoje Klientin duke financuar blerjen tek furnizuesi i tij, bazuar ne parimin murabaha (*shitje me fitim te deklaruar*). Meqenese Klienti do te kete mallrat qe po blihen ne posedimin e tij, Klienti bie dakort qe t'i jape BBSH-se, perpara disbursimit te financimit, garancite dhe mjetet e sigurimit te rena dakort si dhe te paguaje komisionet dhe shpenzimet, sic percaktohet ne kete marreveshje dhe anekset e saj.

Afati i shlyerjes se financimit nen kete marreveshje eshte 1 vit nga data e disbursimit te fondeve, brenda te cilit Klienti duhet te kete shlyer te gjitha detyrimet ndaj BBSH-se nen kete marreveshje. Klienti mund te kerkoste rinovimin (perseritjen) e ketij financimi 1 muaj perpara perfundimit te afatit te tij. Rinovimi do te jete subjekt i analizes se gjendjes financiare te Klientit nga ana e BBSH-se. Nese BBSH pranon kerkesen per rinovim, palet do ta konfirmojne kete ne nje dokument te shkruar e firmosur rregullisht. Rinovimet do te behen sipas nevojave te biznesit te Klientit dhe Kushteve te Biznesit e Listes se Cmimeve te BBSH.

Neni 3 - Cmimi

- (a) Komision disbursimi ne masen 0.5% te financimit do te paguhet nga Klienti ne momentin e disbursimit te fondeve.
- (b) Fitimi i BBSH-se do te jete 3.5% ne vit, i pandryshueshem, mbi shumen e financimit. Norma efektive e fitimit do te jete 4.09% ne vit. Metoda e llogaritjes se tij eshte proporcionale 30/360 e cila, se bashku me kostot e ketij financimi paraqiten te detajuara ne Tabelen e Shlyerjes se Financimit bashkengjitur kesaj marreveshje, qe eshte pjese integrale e saj.
- (c) Komision mirembajtjeje 3% mbi shumen e financimit qe do te llogaritet nga data e maturimit deri ne daten e shlyerjes se financimit.
- (d) Te gjitha shpenzimet per kete financim, shpenzimet noteriale per kontratat, shpenzimet e bllokimit te prones-garanci, shpenzimet e vleresimit nese ka e shpenzime te tjera qe lidhen me financimin dhe shlyerjen e tij do te paguhen nga Klienti ne kohen e kryerjes se tyre. Klienti autorizon BBSH t'i zbrese keto shuma nga llogaria qe ai ka prane BBSH-se, nga cdo llogari qe ai ka pavaresisht monedhes se saj.

Klientet bien dakort qe ne rast kembimi te monedhes nga llogarite e tyre per pagimin e shumave te detyrueshme sipas kesaj marreveshje, banka do te zbatoje kursin e saj zyrtar te dites kur kryhet kembimi, pa marre autorizim tjeter prej tij. Te gjitha pagesat do te behen neto nga taksat, tarifat ose zbritje te cdo lloji qe paguhen ne Shqiperi, sipas legjisacionit.

Neni 4 - Reziqet e ndryshimit te kursit te kembimit

Klienti deklaron se i jane bere te njoitura nga BBSH te gjitha rreziqet qe mund t'i sjelle aktivitetit dhe qarkullimit te tij te parase financimi ne nje monedhe te ndryshme nga ajo e arketimeve te tij. Gjithashu, Klienti eshte i vetedijshem se mund te pesoje humbje gjate kohes se shlyerjes se financimit si pasoje e ndryshimit te kursit te kembimit te monedhes. Klienti eshte dakort dhe pranon qe financimi t'i behet ne monedhen e caktuar me lart ne kete marreveshje dhe ta shlye financimin ne po kete monedhe.

Neni 5 - Shlyerja

Klienti do te shlyeje te gjithe shumen e financimit brenda 12 muajve, nepermjet 11 kesteve te para mujore prej **860.42 USD**-(teteqind e gjashtedhjete pike dyzet e dy) secili, qe perbehet vetem nga fitimi i BBSH-se dhe kestit te 12-te prej **295,860.42 USD**-(dyqind e nentedhjete e pese mijë e teteqind e gjashtedhjete pike dyzet e dy) qe perbehet nga shuma e financuar nga BBSH dhe fitimi i BBSH nga ky financim murabaha, te cilet se bashku perbejne Cmin e Shitjes, sic jane percaktuar ne Tabelen e Shlyerjes se Financimit bashkengjitur kesaj marreveshje, e cila eshte pjese perberese e saj. Klienti eshte dakort te ribleje pjesen e BBSH-se sipas dispozitave ligjore dhe parimeve te bankingut islamik nepermjet pagimit te ketyre kesteve.

Klienti ketu autorizon BBSH-n te zbrese shumen e cdo kesti te pagueshem nga llogarite e tij prane BBSH, si dhe komisionet apo penalitetet qe mund te jene apo behen te pagueshme. Klienti do te siguroje qe kjo shume te jete ne dispozicion ne kete llogari ne daten e caktuar ne fonde te pastra. Klienti njeh dhe pranon te drejten e BBSH-se per te debituar shumat e detyrimeve nga cdo llogari e tij ne BBSH, pavaresisht nga monedha, pa autorizim tjeter prej tij. Klienti ketu heq dore nga kerkesa per t'u njoftuar per pagesen, protesta dhe nga e drejta per proteste.

Neni 6 - Mospermbushja e detyrimeve

Shlyerja e financimit nga Klienti do te filloje nje muaj nga dita e disbursimit dhe do te vazhdoje ne te njejt date te cdo muaji vijues. Ne qofte se data e pageses nuk do te jete dite pune, atehere ajo do te paguhet nga Klienti diten e punes pasardhese. Koha e pageses do te jete thelbesore. Ketej e tutje nese kesti ose detyrime te tjera nuk do te paguhen brenda 30 diteve nga data e caktuar, do te quhet se Klienti e ka shkelur kete Marreveshje dhe BBSH do te kete te drejten te kerkoste shlyerjen/ kthimin e menjehershem te te gjithe shumes se mbetur te financimit se bashku me fitimin dhe gjobat qe do te llogariten deri ne diten e pagimit te tyre.

Ne rast se Klienti nuk paguan ne daten e caktuar, ai pranon te paguaje nje gjobe te llogaritur me fitimin e rregullt te financimit plus 2% ne vit shtese mbi pjesen e financimit te BBSH-se ne kestin e vonuar per cdo

dite vonese. Shumat e gjobave do te depozitohen ne fondin e bamiresise se BBSH-se dhe do te administrohen sipas udhezimeve te nje komiteti te drejtar nga Keshilltari i Sheriatit te BBSH-se.

Neni 7 - Pasojat e Mospermbushjes

Nese ndonje nga kushtet e kesaj marreveshjeje shkeler ose nuk permbushet nga ana e Klientit, kjo perben nje Rast Mospermbushjeje. Ne kete rast Klienti dhe Dorezanesi i njohin te drejtene BBSH-se te ngrije llogarite dhe depozitat e tyre ne BBSH.

Ne qofte se ndodh nje Rast Mospermbushjeje, atehere BBSH mundet ne zgjedhjen e saj, duke njoftuar Klientin, te deklaroje te gjithe ose nje nje pjese te principalit dhe fitimit te financimit (se bashku me shuma te tjera te pagueshme nen kete marreveshje) se ato jane dhe do te behen, ose:

- te maturuara dhe te pagueshme kundrejt kerkeses; ose
- menjehere te maturuara dhe te pagueshme pa njoftim tjetër dhe pa kerkese ose kundershtim te asnjë lloji, prej te cilave hiqet dore ketu shprehimisht nga Klienti.

Neni 8 - Perfundimi i marreveshjes dhe llogaritja e penaliteteve

Kjo marreveshje si dhe te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj, do te perfundojne vetem kur Klienti te kete shlyer detyrimet e tij ndaj BBSH-se. Penalitetet per vonesa ne pagese do te llogariten deri ne diten e pagimit te tyre ose ne diten e shlyerjes se detyrimeve nepermjet ekzekutimit te garancive.

Neni 9 - Garancia dhe Mjetet e sigurimit

Me qellim garantimin e interesave te BBSH-se ndaj mospermbushjes se detyrimeve te Klientit, Klienti jep mjetet e meposhtme te sigurimit te detyrimeve:

- Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 3/461-N3 e ndodhur ne ZK 8592, Vol. 41, Fq. 208 ne Shkoder**. Kjo pasuri Njesi me siperfaqe prej 26m² eshte pjese e nje pallati 6-katesh ne L. Naim Gjylbegu, Rr. Bujar Bishanaku dhe ajo perdoret si njesi sherbimi me lartesi kati 4.00 m, ne pronesi te Nikolin Dedvukaj sic vertetohet nga Certifikata e pronesise nr. 1240396 date 25.08.2015 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 29.06.2018.
- Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 3/461-B e ndodhur ne ZK 8592, Vol. 41, Fq. 205 ne Shkoder**. Kjo pasuri Bodrum me siperfaqe prej 230.6m² eshte pjese e nje pallati 6-katesh ne L. Naim Gjylbegu, Rr. Bujar Bishanaku dhe ajo perdoret si njesi sherbimi me lartesi kati 4.00 m, ne pronesi te Nikolin Dedvukaj sic vertetohet nga Certifikata e pronesise nr. 1240392 date 25.08.2015 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 28.06.2018.
- Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 16/356 volum 31 faqe 36 e ndodhur ne ZK 8593 ne Shkoder**. Kjo pasuri Truall me siperfaqe prej 290m² dhe Ndertese 101.20m² e ndodhur ne kryqezimin e Rr. Stacioni i Trenit me Rr. Pal Engjelli, ne pronesi te Nikolin Dedvukaj dhe Roza Dedvukaj sic vertetohet nga Certifikata e pronesise nr. 1350722 date 04.08.2016 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 29.06.2018. Kjo pasuri ka hyrje nga trotuari i rruges se stacionit te trenit, ish shtepi banimi 1 kateshe me oborr, perdoret si pike shitje gazi te lengshem. Ndertesa 101.2 m² perbehet nga nje verande ne hyrje, koridor, ambient ndenje gatimi, dy dhoma gjumi, banjo. Nje dhome perdoret si zyre dhe vendroje per piken e gazit.
- Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 16/231 vol. 20 faqe 238, e ndodhur ne ZK 8593, ne registrin hipotekor me nr. 153 date 29.06.2004**, e ndodhur ne kryqezimin e Rr. Stacioni i Trenit me Rr. Pal Engjelli, Shkoder. Kjo pasuri eshte truall me siperfaqe 65 m² dhe ndertese 29 m² dhe funksionon se bashku me pasurine ne piken 3 te ketij neni. Ajo eshte e regjistruar ne pronesi te Nikolin Dedvukaj sic vertetohet nga vertetimi nga dokumentet hipotekore date 29.06.2004. Klienti duhet te dorezoje ne BBSH certifikaten e pronesise dhe kartelen e fresket te kesaj pasurie te paluajtshme, te nenshkrue kontraten e hipotekimit dhe te realizoje inskriptimin e saj ne favor te BBSH-se, brenda nje afati 1 vjecar nga data e kesaj marreveshjeje. Perndryshe, do te konsiderohet shkelje thelbesore e kushteve te kesaj marreveshjeje dhe afati i maturimit te financimit mund te perspejtohet. Ne kete rast, BBSH ka te drejte te kerkoje kthimin e menjehershems te te gjitha detyrimeve te financimit.
- Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 258/12 volum 3 faqe 112 e ndodhur ne ZK 1965 ne Shkoder**. Kjo pasuri Are+Truall+Ndertese me siperfaqe totale 3,192m² nga e cila 1,250m² truall dhe 220m² ndertese, e ndodhur ne Hot i Ri, ne buze te rruges nationale Shkoder-Postrive, Shkoder, ne pronesi te Nikolin Dedvukaj sic vertetohet nga Certifikata e pronesise date 09.01.2001 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 12.03.2019 leshuar nga ZVRPP

Shkoder. Ne baze te raportit te vleresimit date 25.08.2017 te vleresueses Ing. Ermira Mehja kjo pasuri perdoret si pike karburanti dhe pike gazi te lengshem dhe perbehet nga: 3 ndertesa sherbimi vendi i rezervuareve per depozitim e karburantit i cili permban 3 rezervuare, sheshi i distributoreve i perbere nga 2 aparate per nxjerrjen e karburantit dhe tetoja e karburantit, vendi i depozitave te gazit te lengshem se bashku me 8 depozita me kapacite te ndryshme, peshore e makinave, piste per mbushje bombolash, zyra, repart mekanik, reparti i kolaudimit te bombolave, linja e pastrimit te bombolave, vend roje, te cilat jane te gjitha pjese perberese e prones qe hipotekohet.

6. Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 23/22 volum 4 faqe 153 e ndodhur ne ZK 1965 ne Shkoder**. Kjo pasuri Truall me siperfaqe prej 1,374m² dhe Ndertesa me gjurmë 277.7m² e ndodhur ne Rr. Ded Gjo Luli, Hot i Ri, Shkoder. Ajo eshte e perbere nga ndertesa 1-kat me siperfaqe 98m² dhe ndertesa 3-kat+bodrum me siperfaqe bodrumi 75m², kati perdhe 179.7m², kati i pare 179.7m² dhe kati i dyte 80m² +100m² tarrace, e regjistruar ne pronesi te Nikolin Dedvukaj sic vertetohet nga Certifikata e pronesise date 29.08.2007 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 12.03.2019 leshuar nga ZVRPP Shkoder.
7. Hipoteke te radhes se pare e te vetme te regjistruar ne favor te B.B.SH-se mbi **Pasurine me nr. 546/3 volum 1 faqe 3 e ndodhur ne ZK 3079 ne Qafe-Grade, Malesi e Madhe**. Kjo pasuri Truall me siperfaqe prej 3,162m² dhe Ndertesa 1,540m², e regjistruar ne pronesi te shoqerise "ALPIN" SH.P.K. sic vertetohet nga Certifikata e pronesise Nr. 1312770 date 30.01.2017 dhe kartela e pasurise se paluajtshme date 13.03.2019 leshuar nga ZVRPP Malesi e Madhe. Kjo pasuri perbehet nga ndertesa 440m² e cila perdoret si repart pune se bashku me impjantin per ambalazhimin e ujit "Alpin" i cili eshte instaluar ne te si dhe magazina me siperfaqe 1,100m², te cilat jane te gjitha pjese perberese e prones qe hipotekohet.
8. **Barre siguruese mbi te gjitha pasurite te cilat nuk jane pjese e pazgjidhshme e pasurise se paluajtshme**, te ndodhura ne piken e karburantit dhe piken e gazit te lengshem te pershkruara ne piken 5 te ketij neni, te cilat ne baze te raportit te vleresimit date 25.08.2017 te vleresueses Ing. Ermira Mehja perbehen nga:
- 3 rezervuare per depozitim e karburantit, nga te cilet 2 x 54,000 litra nafte dhe 1 x 10,000 litra benzine;
 - 2 aparate per nxjerrjen e karburantit, ng ate cilet nje me 4 pistoleta dhe nje me 2 pistoleta;
 - 8 depozitat e gazit te lengshem me kapacite: 1 x 120,000m³, 3 x 100,000m³, 2 x 5,000m³ dhe 2 x 1,000m³;
 - peshore e makinave;
 - piste per mbushje bombolash;
 - repart pune mekanik,
 - reparti i kolaudimit te bombolave,
 - linja e pastrimit te bombolave.
9. **Barre siguruese mbi Impjantin per ambalazhimin e ujit te pijshem "Alpin" i ndodhur ne pronen e pershkruar ne piken 7 te ketij neni.** Ky impjant perbehet nga:
A- Linja e ambalazhimit te ujit te pijshem "Alpin" ne bidona plastik 8 litra;
B- Linja e ambalazhimit te ujit te pijshem "Alpin" ne shishe plastike 0.5 litra dhe 1 liter;
C- Linja e ambalazhimit te ujit te pijshem "Alpin" ne shishe qelqi 0.25 litra dhe 0.75 litra;
D- Sektori ndihmes;
se bashku me te gjitha makinerite dhe pajisjet perberese te tyre qe pershkruhen me hollesi ne raportin e vleresimit date 8 Gusht 2017 te vleresuesit Ing. Kristaq Konduri.
10. **Barre siguruese per emimin e blerjes se makinerive, pajisjeve dhe mallrave te shoqerise "Alpin" sh.p.k.** qe jane financuar nga BBSH dhe pershkruhen ne listen date 17.07.2018 perqatitur nga Barredhenesi, te cilat perbehen nder te tjera nga:
- a) Makineri linje automatike per mbushje bidoni me uje 13 litra, 19 litra, Reliable Machinery, China;
 - b) Makineri per grirje/bluarje plastmasi nga Guangzhou longhe machinery trade China;
 - c) Ftohesa uji te vegjel (per zyra me bidon) nga Cixi Saiyan Electric Appliance Factory China – 476 cope;
 - d) Frigorifera per ftohje uji me shishe ose slim cooler 160L nga Procool Refrigeration China – 55 cope;
 - e) Mini water dispenser ose cezme me rubinet Cixi Saiyan Electric Appliance Factory China – 3680 cope;

- f) Paleta plastike per vendosjen dhe ruajtjen e bidonit gjate transportit nga Qingdao Huading – 350 cope;
- g) Ftohesa te medhenj nga Cixi Saiyan Electric Appliance Factory China;
- h) Frigorifera shine nga Weili Kitchen Equipment China;
- i) Bidon policarbonat bosh 19 litra nga Nakliye Plastic Turkey – 2320 cope;
- j) Bidon policarbonat 13 litra nga Greif Poland – 3402 cope;
- k) Tapa plastike nga Bikos Epiprotick Bottling industry Greece – 3,276,000 cope.
11. Barre siguruese mbi aksionet e shoqerive tregtar ““DEDVUKAJ” sh.p.k., “MONDI” SH.A. dhe “ALPIN” sh.p.k.. Ky mjet sigurimi duhet te jete i regjistruar ne regjistrin e aksioneve te vete shoqerive, ne QRA, ne RBS dhe ne regjistrin tregtar te shoqerive ne QKB.
12. Barre siguruese mbi te gjithe pasurite e luajtshme, ekzistuese dhe te ardhme, perfshire makinerite dhe pajisjet e biznesit te shoqerive ““DEDVUKAJ” sh.p.k., “MONDI” SH.A. dhe “ALPIN” sh.p.k..

Klienti, ne cilesine edhe te Hipotekuesit e Barredhenesit, shprehimisht bien dakort qe garancite dhe mjetet e sigurimit te dhena per Marreveshjen e Financimit Nr. 838 Rep. Nr. 442 Kol. date 26.06.2018 lidhur ne prani te noteres Erida E. Hoxha e Dhomës se Noterise Shkoder, te mbeten ne fuqi dhe me vlerë te plete ligjore si garanci per sigurimin e detyrimeve qe rrjedhin edhe nga ky rinnovim i marreveshjes.

Per kete qellim palet kane nenshkruar Kontratat e Hipotekimit Nr. 844 Rep. Nr. 448 Kol. date 26.06.2018 dhe Nr. 884 Rep. Nr. 443 Kol. date 09.03.2019 dhe Marreveshjet e Barreve Siguruese Nr. 843 Rep. Nr. 447 Kol. date 26.06.2018 dhe Nr. 961 Rep. Nr. 521 Kol. date 18.07.2018 si dhe do te nenshkruajne dhe nje Marreveshje te re te Barreve Siguruese, te cilat konsiderohen te gjitha pjese integrale e kesaj marreveshje financimi dhe palet bien paraprakisht dakord qe ato do te mbahen ne fuqi, me vlerë te plete juridike edhe ne rastin e financimit te shumave te reja si dhe per forma te ndryshme te perdorimit te tyre deri ne limitin total te miratuar nga BBSH per kete Klient, pa patur nevoje per ribllokime pasurish te vena si kolateral me aktet e siperpermendura. Keto prona jane vleresuar dhe vete Klienti i vetedijshem per vleren dhe gjendjen reale te tyre ka rene dakort se ato jane te nevojshme per te mbuluar dhe garantuar shumen e detyrimit qe rrjedh nga kjo marreveshje.

Klienti/Hipotekuesi/Barredhenesi pa miratimin paraprak te BBSH nuk do te kryejne veprime per tjetersimin e pasurive ose pjeseve te tyre, per kalim pronesie, pjestim pasurie, dhurim, shitje etj, ne pronen mbi te cilin eshte krijuar hipoteka, por edhe cdo pasuri qe mund te lidhet me kete pasuri ne menyre te pazgjidhshme gjate kohe zgjatjes se kesaj marreveshje, persa kohe nuk ka shlyer plotesish financimet, fitimin e BBSH, komisionet, penalitetet dhe shpenzimet e tjera te lidhura me to. Cdo veprim ne kundershtim me kete nen do te beje te kthyeshem menjehere financimin bashke me shpenzimet, fitimin, penalitetet, demet, kamatat dhe cdo shpenzim tjeter. Klienti/Hipotekuesi/Barredhenesi nuk do te krijojne ndonje hipoteke, peng, kompesisim, garanci, servitut, uzufruk, barre siguruese, apo edhe cdo kufizim tjeter mbi keto pasuri pa miratimin paraprak te BBSH.

Neni 10 - Sigurimi

Klienti eshte dakort t'i siguroje pasurite e pershkruara me lart qe sherbejne si garanci me nje kompani sigurimesh te pranuar nga BBSH, nga te gjitha rreziqet, perfshire permbytjen, termetin dhe zjarrin, per gjithe periudhen e marreveshjes. BBSH do te jete i vetmi perfitures ne polisen e sigurimit. Klienti merr persiper te zbatoje te gjitha kushtet e vendosura ne polisen e sigurimit perfshire detyrimin qe ne rast aksidenti ose demtimi te pasurise, ai te njoftoje menjehere BBSH-ne dhe shoqerine e sigurimit dhe te beje gjithcka te mundur per mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurise sipas kushteve te polices se sigurimit. Ne rast te shkatteredimit total te prones per shkaqe te forces madhore, kontrata do te perfundoje dhe do te kete nje periudhe faljeje deri ne pagimin nga shoqeria e sigurimit. Shuma e mbetur e financimit do te shlyhet nga shumat e paguara nga shoqeria e sigurimit. Klienti gjithashtu eshte i detyruar qe, me kerkesen e BBSH ose te shoqerise se sigurimit, te plotesoje cdo kerkesa lidhur me kushtet e sigurimit dhe te beje gjithcka kerkohet ne lidhje me te. Cdo pagese lidhur me sigurimin e pasurise se paluajtshme duhet t'i paguhet BBSH-se nga shoqeria e sigurimeve. Megjithate, pagesa e sigurimeve do te ndahet ndermjet te dyja paleve ne perputhje me shumen e detyrimeve te Klientit ne daten e pageses. Klienti eshte persegjegjes qe gjithe gjithe periudhes se kesaj marreveshje ta mbaje pasurine te siguruar duke paguar primet per cdo vit dhe/ose autorizon ketu BBSH te debitoje shumen e primit nga llogaria e tij cdo vit, pa patur nevoje per njofsim dhe autorizim tjeter per kete qellim. BBSH ka te drejte te marre pjesen e saj ne pronesi pa fitim shtese.

Neni 11 - Shlyerja e parakohshme

Palet kane rene dakort qe Cmimi i Shitjes do te paguhet brenda afatit te percaktuar me lart ne kete marreveshje. Megjithate, Klienti, mund t'i paguaje detyrimet perpara afatit te percaktuar. Ne kete rast, BBSH mund te vendose t'i jape nje shume te pacaktuar si dhurate Klientit.

Neni 12 - Kushte te tjera

Gjate periudhes se kesaj marreveshjeje, Klienti merr persiper gjithashtu te plotesoje kushtet e meposhtme:

- (a) Nese BBSH merr dijeni per ndonje ceshtje materiale lidhur me informacionin qe ka dhene klienti per marrjen e financimit ose me pas, deklaratat e bera dhe garancite e dhena prej tij, ceshtjeve financiare, pronesore, ligjore, civile ose shoqerore mbajtjen e aksioneve, gjendjen financiare ose mospermbushje detyrimesh ndaj te treteve, qe nuk i jane bere te ditura BBSH-se prej klientit ose jane dhene te pasakta, atehere angazhimi i BBSH-se sipas kushteve te kesaj marreveshjeje do te konsiderohet i perfunduar dhe BBSH ka te drejte te terhiqet nga marreveshja ose te pershpejtoje maturimin e detyrimeve te Klientit.
- (b) Nuk duhet te lene ne hipoteke apo peng apo te vere barre cfaredo mbi pronat e tyre apo te dalin dorezanes per te trete, pa lejen me shkrim te BBSH-se, deri ne shlyerjen e plete te detyrimeve te tij kundrejt BBSH-se.
- (c) Te mos i rrisin detyrimet ndaj te treteve pa pelqimin e BBSH-se.
- (d) Te dorezojne rregullisht ne BBSH pasqyrat financiare dhe dokumenta te tjera sic mund te kerkohen nga BBSH;
- (e) Te lejojne kontroll nga ana e BBSH-se te dokumentave, regjistrimeve te biznesit dhe perdorimin e fondeve;
- (f) Te dorezoje vleresime te kolateralit te kryera nga eksperte te licensuar sipas kerkeses se BBSH-se, gjate kohezgjatjes se kesaj marreveshjeje.
- (g) Mosushtimi ose vonesa nga ana e BBSH-se ne ushtrimin e te drejtave, pushteteve ose privilegjeve ketej e tutje nuk do te veproje si nje heqje dore prej tyre dhe ushtrimi i vetem ose i pjesshem i ketyre te drejtave, pushteteve ose privilegjeve nuk do te ndaloje ushtrimin e metejshem te te drejtave apo pushteteve ose privilegjeve te tjera. Te drejtat e siguruara shprehimisht ketu jane kumulative dhe jo perjashtuese te te drejtave qe BBSH do te kishte per arsyte te tjera.
- (h) BBSH do te gezoje te gjitha te drejtat qe i takojne ne baze te Kushteve te Pergjithshme Per Financimin dhe Kolateralin qe eshte bashkengjitur si aneksi 1 dhe formon nje pjese integrale te kesaj Marreveshje Financimi.

Neni 13 - Adresat, Kerkesat ose Njoftimet

Palet pohojne se adresat e tyre jane ato te dhena ne fillim te kesaj marreveshjeje dhe ne rast te ndryshimit te adreses, secila pale merr persiper detyrimin te informoje tjetren me shkrim jo me vone se 10 dite nga ndryshimi. Te gjitha njoftimet, kerkesat ose komunikime te tjera ketej e tutje do te konsiderohen te dhena rregullisht kur i dorezohen me shkrim, me telefon, faks ose e-mail Klientit ne adresen dhe kontaktet e fundit te deklaruara prej tij ne BBSH.

Neni 14 - Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e te Dhenave Personale

Palet marrin persiper te trajtojne si rigorozisht konfidencial cdo informacion qe merret ne lidhje me ceshtjet e kesaj marreveshjeje, Klientit dhe cilidto individe dhe shoqeri qe jep garanci per detyrimet e Klientit. Ne zbatim te Nenit 127 te Ligjit per Bankat ne Republiken e Shqiperise dhe Rregullores se Bankes se Shqiperise Nr. 67 date 13.10.2010 "Per permabujtjen e informacionit dhe funksionimit te Regjistrat te Kredive ne Banken e Shqiperise" Klienti jep pelqimin qe te dhenat e tij te trajtohen ne Regjistrin e Kredive prane Bankes se Shqiperise, sipas Klauzoles se Pelqimit Paraprak bashkengjitur kesaj marreveshje.

Gjithashtu ne zbatim te Ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", Klienti autorizon BBSH per perpunimin dhe transferimin e te dhenave personale dhe financiare te tij, vetem sipas kerkesave te ligjit.

Neni 15 - Pershpejtimi i Maturimit

Mos-permbushja e ndonjerit prej kushteve te kesaj marreveshjeje nga Klienti do te coje ne perfundimin e parakohshem te marreveshjes, nese kjo vendoset nga BBSH. Diten ne te cilen BBSH do te dergoje nje njoftim per perfundimin e marreveshjes, e gjitha shuma e detyrimeve te Klientit do te konsiderohet e maturuar dhe e detyrueshme per pageset.

Neni 16 - Mospagese Interesi

Asgje ne kete marreveshje nuk detyron ose i jep te drejte paleve te paguajne ose te marrin interes mbi shumat e pagueshme. Gjate periudhes se kesaj marreveshjeje, Klienti detyrohet te mos ndermarre asnjë veprimitari lidhur me subjektin e kesaj marreveshjeje, qe eshte ne kundershtim me rregullat e bankingut islamik.

Neni 17 - Shpenzimet

